

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Të nderuar qytetarë,

Konstituimi i një parlamenti dhe fillimi i një legjislature të re, do të duhet të ishte kurorëzimi i një gare demokratike dhe një ditë e shënjuar për zhvillimet politike të çdo vendi. Ashtu sikurse ndodh në të gjitha vendet normale, mandati i ri i Parlamentit do të duhet të konsiderohej një ditë progresi për demokracinë, zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë, por, fatkeqësisht, nuk është rasti i këtij Parlamenti dhe i kësaj mazhorance. Nuk është rasti, pasi tashmë është bërë e ditur në sytë e të gjithë opinionit publik, i madh e i vogël e di në Shqipërisë, se kjo është mazhorancë e cila nuk ka dalë nga një garë e lirë, demokratike dhe e barabartë, por nga një garë e manipuluar me të gjitha format dhe mjetet e mundshme që pushteti dhe krimi i lidhur me të ka pasur në zotërim, duke bërë që të deformohet vullneti i qytetarëve shqiptarë.

Të nderuar qytetarë, dua ta theksoj fortë dhe qartë, se Partia Demokratike dhe opozita në zgjedhjet e 25 prillit nuk garoi kundër Partisë Socialiste, por kundër shtetit të vënë në dispozicion të krimit dhe bandave lokale, kudo. Nuk është e ekzagjeruar aspak, nëse sot, kur diskutohet për qeverinë e re në punimet e kësaj legjislature, të themi se shteti, pushteti dhe grupet kriminale tashmë në të gjithë territorin e republikës janë një. Struktura të tëra të tij kriminale, administrative, policore dhe financiare u vunë në dispozicion të partisë në pushtet, duke harruar funksionet e tyre të vërteta dhe duke favorizuar në të gjitha mënyrat partinë në pushtet. Buxheti i shtetit, paratë e të gjithë qytetarëve shqiptarë, u harxhuan për të deformuar garën e 25 prillit, duke shkelur në mënyrë flagrante të gjitha ligjet e vendit dhe parimet e shtetit demokratik. Mjafton këtu të përmendim rastin e patronazhistëve, të cilët nuk kishin asnjë rol tjetër përveçse të shantazhonin dhe të ushtronin presionin mbi qytetarët, duke shkelur të gjitha normat e lirisë dhe të privatësisë. E megjithatë asnjë hetim nuk ndodhi për asnjë prej nëpunësve, e kundërta, media, e cila e publikoi, u vendos nën hetim, një shenjë e qartë e uzurpimit që ky pushtet u ka bërë instancave shtetërore, të cilat paguhen nga taksapaguesit shqiptarë për të zbatuar ligjin. Në çdo vend të botës një rast i tillë do të përbënte skandal, ndërsa për partinë-shtet ky aksion kundër lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut meritonte vetëm lëvdata dhe vazhdon të trajtohet me lëvdata. Këto nuk janë fenomene të cilat sajohen nga Partia Demokratike për justifikim, këto janë fenomene të shkruara e zeza mbi të bardhë në të gjitha raportet e organizatave ndërkombëtare që monitoruan zgjedhjet e 25 prillit. Për të gjitha këto arsye, kjo mazhorance mund të qëndrojë në pushtet formalisht, por përmbajtësisht, nuk ka asnjë lidhje me parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës.

Prandaj, zgjedhjet e 25 prillit, nuk ka asnjë diskutim që shënjuan regres për përfaqësimin dhe demokracinë shqiptare. Në këtë kuptim, kjo legjislaturë dhe ky pushtet do jetë po njësoj si dy legjislaturat e kaluara, ku u shënua numri rekord i njerëzve me precedentë kriminalë të veshur me kostumin e pushtetit, ku u aprovua numri rekord i koncesioneve në favor të një grushti njerëzish, ku rritja e taksave arriti nivele të papara ndonjëherë, ku deputetët u kthyen në kukulla që aprovonin ligje me urdhër të Edi Ramës, për interesat financiare të miqve dhe të bashkëpunëtorëve të afërt të tij, ku pushteti u përdor për të pasuruar disa e për të varfëruar pjesën më të madhe të qytetarëve shqiptarë, që tashmë kanë marrë rrugën drejt Europës, duke thyer të gjitha rekordet e numrit të azilkërkuesve për frymë, ku asnjë hap para nuk u shënua në procesin e integritit evropian të Shqipërisë. Përkundrazi, çdo ditë e më shumë ky pushtet po tenton të rrëshqasë drejt modelit të autoritarizmave

lindorë. Është e qartë, se pushteti i fituar me ndihmën e bandave dhe krimit të organizuar, nuk do të sjellë asnjëherë progres për qytetarët e tij. Fakti që ne sot jemi këtu për të ushtruar funksionin tonë të deputetit, nuk do të thotë aspak se e njohim këtë qeveri si demokratike dhe legjitime dhe përfaqësuese të interesave të qytetarëve shqiptarë. Nuk do të thotë aspak se do të jemi patericë e një regjimi, përkundrazi. Jemi këtu, për të respektuar votuesit tanë dhe për të çmontuar partinë-pushtet në interes të qytetarëve shqiptarë dhe të ardhmes së tyre. Jemi të vetëdijshëm se kjo nuk është aspak e lehtë, por bindja se beteja jonë për të mirën e vendit duhet të vazhdojë në të gjitha frontet, na ka sjellë edhe sot këtu. Partia Demokratike nuk do të ndalë në asnjë moment betejën e saj kundër korrupsionit që ka pllakosur të gjitha hallkat shtetërore, kundër padrejtësive në dëm të qytetarëve, kundër varfërisë dhe kundër regresit që Edi Rama po e çon gjithmonë e më shumë këtë vend, me të gjitha mënyrat, me të gjitha mjetet. Ka nga ata të marrë që ëndërrojnë shkrijen e Partisë Demokratike apo nga ata që thonë se Partia Demokratike e ka mbyllur misionin e saj. Do të zhgënjeheni shumë shpejt. Partia Demokratike është partia me e suksesshme e tranzicionit shqiptar. Është partia që e ka të lidhur historinë e saj me demokracinë. Më kot keni iluzione. Ajo to të rritet bashkë me zhvillimin që do të marrë Shqipëria dhe askush nuk mund t'ia marrë këtë histori. Më kot shpresoni ta zhbëni këtë histori. E di që nga ana tjetër ka njerëz që ju vjen turp për historinë politike të partisë së tyre në të kaluarën dhe për historinë e partisë politike në këto vite të Rilindjes, është e kuptueshme, por duhet ta ketë çdokush të qartë, se Partia Demokratike jo vetëm që përbën historinë më të bukur të dekadave të fundit të historisë së Shqipërisë, por është padyshim dhe e ardhmja e saj, pasi është e vetmja forcë politike që mund ta zhvillojë dhe ta çojë përpara këtë vend.

Prandaj, kam një thirrje për të gjithë demokratët: “Ndhuni krenar që jeni demokratë, ndihuni krenarë për partinë tuaj dhe për vlerat që ajo ka përfaqësuar dhe gjithmonë do të përfaqësojë bashkë me ju”. Falë besimit tuaj, falë bindjeve tuaja, Partia Demokratike, pavarësisht represionit, pavarësisht bandave, pavarësisht shit-blerjes së votës, arriti që të marrë thujse 40% të mbështetjes së votuesve duke treguar faktin e qartë që ka besimin e qytetarëve në mënyrë të plotë tek ajo dhe te përfaqësuesit e saj.

Të nderuar demokratë, e di shumë mirë që këto nuk kanë qenë vite të lehta për ju. Shpeshherë keni vuajtur përndjekjen e pushtetit, shpeshherë jeni larguar nga puna vetëm se jeni demokratë apo jeni detyruar të emigroni apo t'ju emigrojnë fëmijët për faj të kësaj qeverie, por ama, ju me qëndrueshmërinë tuaj, me vlerat që besoni, do të bëni shumë shpejt që këtij regjimi t'i vijë fundi. Kjo është një betejë që ia vlen të bëhet për të mirën e qytetarëve shqiptarë, për të mirën e të gjithë shqiptarëve. Sigurisht, gjatë këtyre viteve Partia Demokratike ka pasur gabimet e saj, por në të gjitha momentet, në të gjitha vendimet nuk ka pasur si synim asgjë tjetër përveçse interesin e Shqipërisë dhe të qytetarëve shqiptarë. Dhe vijmë sot në këtë ditë ku duhet të flasim për program dhe kur dëgjon programin në fushën e sigurisë për vendosjen e kamerave, për vendosjen e teknologjisë, për atë që tha Kryeministri në fillim të fjalimit të vet, që dot t'i kapim skutave banditët dhe kriminelët. Në fakt, qeveria dhe përfaqësuesit e saj i kanë kërkuar skutave kriminelët dhe banditë, duke i kthyer në personat më trendi, por i kanë kërkuar politikanët e Rilindjes për t'i kthyer dhe për t'ju marrë votën. I kanë kthyer në personat më të rëndësishëm nëpër zona dhe kur flasim për program në fushën e sigurisë, ka njeri në Shqipëri që nuk e di se përfaqësuesi kryesor i bandave është Edi Rama? A ka njeri në Shqipëri apo kudo në çdo qark, që nuk e di se në çdo cep të territorit është i njëjti model, ku përdoren të njëjtët persona? A nuk e dinë në Korçë që nuk kontrollon Niko, por Ragami? A nuk e dinë në Elbasan që kontrollon banda e Çelajve dhe të tjerët janë kukulla? A nuk e dinë në Durrës, që llumi i bandave të Durrësit dhe i bashkëpunëtorëve të Vangjush Dakos në vite bëjnë ligjin dhe kontrollojnë gjithçka? A nuk e dinë në Fier? Madje edhe deputeti i Partisë Socialiste u tremb nga bandat dhe fuqia e krimit të organizuar, aq sa u detyrua të thotë që institucionet kontrollohen nga krimi. Po kush do ta zbatojë programin e sigurisë dhe rendit në Shkodër, Tom Doshi apo Ilir Beqaj? Po në Vlorë, me

“Damian tërmetin”? Në cilin qytet të Shqipërisë ka mbetur pa u dorëzuar sovranitetit i qytetarëve shqiptarë apo burimet natyrore? Të gjitha emërimet që kanë të bëjnë me administratën shkojnë vetëm te banditët. Shikoni edhe këtu. Një pjesë e madhe, se i shikoj, nuk shihen në kamera, por shihen përballë. Interesat e kujt mbrojnë deputetë që nuk flasin kurrë këtu, interesat e kujt përfaqësojnë? Ja, urdhëroni! Rrahmani i Niklës, deputeti i Shijakut, që s’u di as emrat. Interesat e botës së nëndheshme që përfaqësojnë vetëm dhe vetëm interesat e llumit të shoqërisë. Paçi ditë sa më të shkurtra! Ne do bëjmë gjithçka për këtë. Faleminderit!